



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 565/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt: “Blerje tonera për nevojat të N.J.A të Bashkisë Dibër”, me nr. REF-15088-05-25-2017, me fond limit 1.500.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

Ankimues:

“Infosoft Office” sh.p.k.
Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Dibër
Adresa: Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.05.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt: “Blerje tonera për nevojat të N.J.A të Bashkisë Dibër”, me nr. REF-15088-05-25-2017, me fond limit 1.500.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

II.2. Në datë 31.05.2017, operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për sqarim pranë autoritetit kontraktor, me përmbajtje si më poshtë vijon:

1- Në shtojcën 1, Formulari i Ofertës, ka dy kollona për sasi të tonerave: “Sasia e tonerave të nevojshëm” dhe “Total toner/copë”. Të dyja kollonat kanë sasi të ndryshme nga njëra tjetra. Cila është kollona e saktë e sasive për të cilën duhet të ofertojmë?

Gjithashtu ju lutem na sqaroni për këta artikuj

30	Toshiba eStudio	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes
31	TO – 1640C/D/E K	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes
38	Canon 6000	copë	2	Na jepni modelin / nr e pajisjes
47	Canon 1024	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes

II.3. Bazuar në informacionin e dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në datën 01.06.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje duke sqaruar operatorin ekonomik ankimues dhe ka kryer modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit.

II.4. Në datën 01.06.2017, operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...]

1 - Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, është kërkuar: “Numri i te pakten 2 punonjësve të siguruar. (Per te gjithë periudhen e realizimit të kontrates per te garantuar realizimin e saj).”

Mendojmë që kërkonti vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, E-SIG 01/a. Lutemi konfirmoni që e kemi kuptuar drejt kërkesën tuaj.

2- Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, është kërkuar: “Certifikata ISO 9001-2015 (Per sistemin e menaxhimit të Cilesise) e vlefshme”. Sqarojmë se certifikatat ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015 janë njëloj të vlefshme. Në shtator 2015, organizata ndërkombëtare ISO publikoi versionin e ri të standartit ISO 9001, duke lënë afat kohor një periudhë tranzicioni prej tre vitesh. Pra gjatë periudhës 15.09.2015 – 14.09.2018, certifikimet e akredituara, sipas ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015, janë të vlefshme dhe në fuqi, paralelisht. ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015 janë që të dyja certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë të lëshuara nga organet kompetente, të vlefshme, të rregullta që vërtetojnë standartet e cilësisë. Bashkëngjitur gjeni një dokument të lëshuar nga zyra e përfaqësisë në Tiranë e organizatës certifikuese e ISO 9001, që vërteton se certifikatat ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015 janë që të dyja të vlefshme. Kjo kërkesë e juaja na heq të drejtën të paraqesim ISO 9001:2008, edhe pse ky është një dokument plotësisht i rregullt dhe i vlefshëm, duke kufizuar dhe penguar pjesëmarrjen në tender dhe duke diskriminuar OE në shkelje të neneve 1, 2, 20 të LPP. Në këto kushte kërkojmë që të pranohen të dyja llojet e certifikatave ISO 9001:2008 ose ISO 9001:2015 për të plotësuar këtë kërkesë tuajën.

3- Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, është kërkuar: “Leje Mjedisi e Tipit B.”

Ligji për Lejet e Mjedisit, sqaron qartë rastet kur lëshohet leja e mjedisit tipi B. Objekti i këtij tenderi është blerje tonera dhe kjo lloj leje nuk ka asnjë lidhje me kompanitë që tregëtojnë tonera. Operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë janë tregëtues të tonerave. Kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë, sepse ky kriter nuk është fare në përpjesëtim me natyrën e kontratës që prokurohet, madje nuk ka asnjë lidhje me të.

4- Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, është kërkuar:

“Vërtetim nga Bashkia Dibër se ofertuesi nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Tonë dhe njesive administrative ne varësi të Bashkisë Dibër.” Bashkëngjitur me këtë formular ankese po ju paraqesim një kërkesë për të na pajisur me këtë vërtetim.

5- Në shtojcën 1, Formulari i Ofertës, ka dy kollona për sasi të tonerave:

“Sasia e tonerave të nevojshëm” dhe “Total toner/copë”. Të dyja kollonat kanë sasi të ndryshme nga njëra tjetra. Cila është kollona e saktë e sasive për të cilën duhet të ofertojmë?

Gjithashtu ju lutem na sqaroni për këta artikuj

30	Toshiba eStudio	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes
31	TO – 1640C/D/E K	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes
38	Canon 6000	copë	2	Na jepni modelin / nr e pajisjes
47	Canon 1024	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes

II.5. Në datën 07.06.2017, nëpërmjet shkresës nr. 2656/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke pranuar pjesërisht ankesën. Bazuar në informacionin e dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke arsyetuar si më poshtë vijon:

[...]

1 – Për sa i përket pretendimit të parë të operatorit ekonomik ankimues mbi vërtetimin për formularët E-SIG 01/a, sqarojmë se vërtetimi i dorëzuar pranë AK është i vlefshëm.

2 – Në lidhje me pretendimin e dytë, për certifikatat ISO 9001:2008, KSHA vlerëson si të drejtë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. dhe vlerëson se ankimi i këtij kriteri qëndron.

3 – Për sa i takon ankimimit të kriterit për leje mjedisi të tipit B, ligji nuk parashikon vetëm aktivitetet gjeologjike apo depozitimin gjeologjik por duke qenë se tonerat përmbajnë lëndë plastike dhe dihet rrezikshmëria e plastikës dhe elementëve të saj në mjedis kërkohet që operatorët ekonomikë të jenë të pajisur me këtë leje të lëshuar nga QKL me konfirmim të AKM dhe konkretisht të firmosur nga ministri përkatës. Por edhe parimisht një subjekt që posedon leje mjedisi të tipit B ka kapacitet më të lartë për magazinimin, transportimin dhe asgjësimin e mbetjeve të plastikës, sic parashikohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Për sa më sipër KSHA vlerëson se ankesa e operatorit ekonomik për këtë kriter nuk qëndron.

4 – Për sa i takon ankimimit të pikës 4 për vërtetimin nga Bashkia Dibër, AK merr parasysh kërkesën e operatorit ekonomik për tu pajisur me këtë vërtetim edhe pse kjo nuk është absolutisht detyrë e AK të sigurojë vërtetime për operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurat e prokurimit. Pra, KSHA vlerëson se ankimi i këtij kriteri qëndron.

5 – Për sa i përket specifikimeve të artikujve në sistemin e prokurimit publik do të ngarkohet dokumenti që specifikon këto të dhëna dhe kërkesa për operatorin ekonomik. Sa më sipër KSHA vlerëson se ankimi i këtij kriteri qëndron.

II.6. Në datën 08.06.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

[...]

1- Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, është kërkuar: “Numri i te pakten 2 punonjesve te siguruar. (Per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates per te garantuar realizimin e saj).” Mendojmë që kërkon vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, E-SIG 01/a. Lutemi konfirmoni që e kemi kuptuar drejt kërkesën tuaj. Nuk morëm përgjigje nga AK. Përsëri kërkojmë të përcaktohet qartësisht dokumenti që kërkohet. Është vërtetimi i lëshuar nga organet tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, E-SIG 01/a? Ajo që nuk kuptojmë është çfarë dokumenti mund të garantojë sigurimin e dy punonjësve paradhënie, pasi kontrata ka afat deri në fund të vitit.

2- Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, është kërkuar: “Leje Mjedisi e Tipit B.” Pas ankesës sonë për të hequr këtë kërkesë sepse nuk ka lidhje me objektin e tenderit, AK e ndryshoi duke e bërë: “Leje mjedisi e Tipit B (për magazinimin, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike). Objekti i këtij tenderi është blerje tonera dhe kjo lloj leje nuk ka asnjë lidhje me kompanitë që tregëtojnë tonera. Operatorët pjesmarrës në këtë procedurë janë tregëtues të tonerave. Ligji nuk përcakton që të jepen leje mjedisi të tipit B për magazinimin, trajnim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike), ky aktivitet nuk është fare pjesë e këtij prokurimi, nuk ka lidhje me objektin e tenderit, objekti i tenderit është blerje tonera, të cilat në asnjë rast nuk kthehen në mbetje të pajisjeve elektrike apo elektronike. Ky tender nuk ka asnjë lidhje me pajisjet elektronike, nuk po kërkoheshin pajisje, por edhe sikur të kërkoheshin, në momentin që produkti bëhet mbetje, është në pronësi të autoritetit kontraktor dhe ky i fundit ka përgjegjësinë të trajtojë mbetjet.

3- Më datë 01.06.2017 në përgjigje të kërkesës për sqarim, AK përcaktoi që kollonat “Total toner/cope” ishte ajo që duhej të merrnim parasysht. Më pas në datë 07.06.2017 në një shtojcë të publikuar nga AK përsëri shtojca 1, formulari i ofertës, publikohet me të dyja kollonat “Sasia e tonerave të nevojshëm” dhe “Total tonera”.

II.7. Në datën 22.06.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin për sqarime mbi dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP konstaton se në ankesën parashtruar para autoritetit kontraktor, ndër të tjera ankimesi ka parashtruar kërkesën për sqarime mbi pyetjet si më poshtë vijon:

1- Në kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, është kërkuar: “Numri i te pakten 2 punonjesve te siguruar. (Per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates per te garantuar realizimin e saj).” Mendojmë që kërkon vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, E-SIG 01/a. Lutemi konfirmoni që e kemi kuptuar drejt kërkesën tuaj. Nuk morëm përgjigje nga AK. Përsëri kërkojmë të përcaktohet qartësisht dokumenti që kërkohet. Është vërtetimi i lëshuar nga organet tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, E-SIG 01/a? Ajo që nuk kuptojmë është çfarë dokumenti mund të garantojë sigurimin e dy punonjësve paradhënie, pasi kontrata ka afat deri në fund të vitit.

2- Në shtojcën 1, Formulari i Ofertës, ka dy kollona për sasi të tonerave: “Sasia e tonerave të nevojshëm” dhe “Total toner/copë”. Të dyja kollonat kanë sasi të ndryshme nga njëra tjetra. Cila është kollona e saktë e sasive për të cilën duhet të ofertojmë?

3- Gjithashtu ju lutem na sqaroni për këta artikuj

30	Toshiba eStudio	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes
31	TO – 1640C/D/E K	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes
38	Canon 6000	copë	2	Na jepni modelin / nr e pajisjes
47	Canon 1024	copë	1	Na jepni modelin / nr e pajisjes

III.1.1. Në datën 07.06.2017 autoriteti kontraktor i kthen përgjigje ankimesit mbi kërkesën për sqarime dhe kërkesën e paraqitur mbi modifikimin e kriterëve, ku ndër të tjera sqaron se :

- Mendojmë që kërkon vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, E-SIG 01/a. Lutemi konfirmoni që e kemi kuptuar drejt kërkesën tuaj.

Sqarim: Vërtetimi i dorëzuar pranë AK është ai që është kërkuar nga AK Dibër. Pra ky vërtetim i dorëzuar pranë AK është i vlefshëm.

- “Sasia e tonerave të nevojshëm” dhe “Total toner/copë”. Të dyja kollonat kanë sasi të ndryshme nga njëra tjetra. Cila është kollona e saktë e sasive për të cilën duhet të ofertojmë?

Sqarim: Për sa i përket specifikimeve të artikujve në sistemin e prokurimit publik do të ngarkohet dokumenti që specifikon këto të dhëna dhe kërkesa për operatorin ekonomik.

III.1.2. Në nenin 42, pika 2 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...]Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga njëoperator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr

dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. [...]”

III.1.3. Në parashtrimet dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP konstaton se ndër të tjera ankimuesi ka parashtruar pretendime në lidhje me mënyrën e sqarimit nga ana e autoritetit kontraktor. KPP konstaton se në trajtimin e kërkesës për sqarim nga ana e autoritetit kontraktor, ky i fundit nuk ka dhënë shpjegime narrative mbi çdo kërkesë të bërë nga ana e operatorit ekonomik. Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të japë shpjegime mbi të gjithë kërkimet mbi sqarimet e bëra nga ana e operatorit ekonomik. KPP nënvizon se është në drejtën e operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 42 pika 1 të *lex specialis* ku parashikohet se *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit”*.

III.1.4. Sa më sipër arsyetuar, K.P.P. konstaton se, referuar shkresës 34/8, datë 07.06.2017 për operatorin ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor nuk ka sqaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë të gjitha kërkesat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues. Gjithashtu autoriteti kontraktor duhet të publikojë shtojcën mbi sqarime për çdo kërkesë të operatorit ekonomik ankimues dhe jo vetëm për një pjesë të tyre. Kjo shtojcë të publikohet për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet të sqarojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi kërkesën e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k se: *“Leje Mjedisi e Tipit B.” Pas ankesës sonë për të hequr këtë kërkesë sepse nuk ka lidhje me objektin e tenderit, AK e ndryshoi duke e bërë: “Leje mjedisi e Tipit B (për magazinimin, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike). Objekti i këtij tenderi është blerje tonera dhe kjo lloj leje nuk ka asnjë lidhje me kompanitë që tregëtojnë tonera, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën për Modifikimin e Dokumentave Standarte të Tenderit, *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.4, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:*

[...]

Operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat tekniko- profesionale si me poshtë:

- *Leje Mjedisi e Tipit B (Për magazinimin, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të paisjeve elektrike dhe elektronike)*

III. 2.2. Në nenin 3, pika 13, “Përkufizime”, të ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, parashikohet shprehimisht:

“Leje mjedisi e tipit B” është leja e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila lëshohet nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit B, sipas përcaktimit të këtij ligji dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator

Ndërsa në nenin 4, pika b, parashikohet shprehimisht: *“Leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji”*

III.2.3. Në shtojcën 1, në nëndarjen “Menaxhimi i mbetjeve”, pika 5.7, të ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, parashikohet shprehimisht: *“Magazinin, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike.”*

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “a” dhe “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe 6, parashikohet se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, objekt i procedurës së mësipërme të prokurimit është tregëtimi i materialeve objekt prokurimi. Referuar legjislacionit në fuqi të sipërcituar, ligjvënësi shprehet vetëm për magazinimin, trajtimin, riparimin ose rinovimin e mbetjeve të pajisjeve elektronike dhe jo për tregëtimin e pajisjeve elektronike. Përsa kohë veprimtaria e subjektit ekonomik ankimues nuk konsiderohet e rrezikshme për mjedisin sipas legjilacionit shqiptar në fuqi, pajisja me leje mjedisore e kategorisë B nuk është e domosdoshme, pasi vetëm tregëtimi i këtyre materialeve, nuk mund të konsiderohet aktivitet që mund të ketë ndikim në mjedis. Për këto arsye, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, në lidhje me disponimin Lejes Mjedisore e Tipit B nuk është aspak e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve në pikën 2 të nenit 30, të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt: “*Blerje tonera për nevojat të N.J.A të Bashkisë Dibër*”, me nr. REF-15088-05-25-2017, me fond limit 1.500.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e këtij vendimi brenda 10 ditëve, në përputhje me parashikimet e Vendimit nr. 482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1083 Protokoli,
Datë 08.06.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

